

UDHËZIM
Nr. 5, datë 21.2.2019

PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 17, DATË 3.8.2016, “PËR PROCEDURAT DHE KRITERET PËR NJOHJEN DHE NJËSIMIN NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË TË DIPLOMAVE, CERTIFIKATAVE, GRADAVE SHKENCORE DHE TITUJVE AKADEMIKË TË LËSHUARA NGA INSTITUCIONET E HUAJA TË ARSIMIT TË LARTË DHE INSTITUCIONE TË TJERA TË AUTORIZUARA, JASHTË VENDIT”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 91, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”,

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin nr. 17, datë 3.8.2016, “Për procedurat dhe kriteret për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë, të diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë të lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara, jashtë vendit”, i ndryshuar, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Kudo në përmbajtje të këtij udhëzimi togfjalëshi “Ministria e Arsimit dhe Sportit”, të zëvendësohet me “Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë”, me përjashtim të rasteve të parashikuara në kreun II dhe në pikën 1 të kreut III të tij.

b) Pika 5.4 e kreut IV të udhëzimit riformulohet në këtë mënyrë:

“Për njohjen e gradave shkencore dhe titujve akademikë ngrihen me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin, komisione “ad hoc” sipas fushave përkatëse me pedagogë ekspertë të fushës të kategorisë “profesor”, i cili mblidhet në varësi të numrit të aplikimeve dhe shqyrton dosjet përkatëse. Kryetar i komisionit është zëvendësministri që mbulon çështjet e arsimit të lartë, në ministrinë përgjegjëse për arsimin. Komisioni përkatës nuk mund të mblidhet më vonë se 15 ditë kalendarike pas njoftimit për shqyrtimin e një aplikimi. Në përfundim të procedurave të shqyrtimit komisioni firmos procesverbalin dhe ministri përgjegjës për arsimin lëshon vërtetimin për njohjen e gradës shkencore apo titullit akademik.”.

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe komisionet “ad hoc”.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË**
Besa Shahini